



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 6481 Prot

Peshkopi, më 06.11.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 82

Datë: 03.11.2025.

“Fër dhënien e titullit Qytetar Nderi”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



4083
13/10/20

AKT PROPOZIM

PËR SHPALLJEN "QYTETARE NDERI E BASHKISË DIBËR"

GJENERALMAJOR MANUSHAQE SHEHU

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Dibër,

Komisionit të Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes dhe Komisionit të Kulturës,
Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve

Në mbështetje ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 54 shkronja m dhe të rregullores së Këshillit Bashkiak të Bashkisë Dibër neni 49, si dhe në respekt të kontributeve të veçanta të personaliteteve me origjinë dibrane që kanë nderuar vendlindjen e tyre në arenën kombëtare e ndërkombëtare, propozohet:

Objekti i Propozimit:

Shpallja "Qytetare Nderi e Bashkisë Dibër" e Gjeneralmajor Manushaqe Shehut, për kontributin e jashtëzakonshëm në fushën e mbrojtjes, sigurisë kombëtare, si dhe në promovimin e figurës së gruas shqiptare në strukturat më të larta të shtetit dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Arsyetimi:

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu, e lindur më 5 nëntor 1965 në Peshkopi, është ndër figurat më të spikatura të historisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ajo vjen nga një familje dibrane me tradita të shëndosha dhe që në rini ka shfaqur pasion e përkushtim për uniformën ushtarake, duke u bërë shembull frymëzimi për brezat e rinj.

Gjatë një karriere të gjatë prej mbi 37 vitesh në shërbim të Atdheut, gjeneralmajor Shehu ka mbajtur detyra të rëndësishme komanduese dhe drejtuese në të gjitha nivelet e ushtrisë shqiptare, përfshirë:

- Shefe e Logjistikës në Brigadën 3900, Peshkopi;
- Drejtuese në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Këshilltare Ushtarake e Presidentit të Republikës;
- Drejtoreshë e Bashkëpunimit Civil–Ushtarak;
- Komandante e Akademisë së Nënoficerëve;
- Komandante e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes;
- Zëvendësshefe e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- Për një periudhë të shkurtër, edhe Shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Me Dekretin nr. 1313, datë 17.06.2021, të Presidentit të Republikës, ajo u shpall e para grua shqiptare me gradën madhore Gjeneralmajor, duke bërë histori dhe nderuar emrin e Dibrës.

Përveç aftësive profesionale dhe akademike, gjeneralmajor Shehu është njohur për integritetin, urtësinë dhe përkushtimin e saj si nënë, qytetare dhe përfaqësuese e denjë e komunitetit dibran. Ajo ka dhënë kontribut të çmuar në forcimin e rolit të gruas në shërbimet ushtarake, në nxitjen e barazisë gjinore dhe në bashkëpunimet ndërkombëtare të ushtrisë shqiptare.

Duke qenë një figurë e spikatur në nivel kombëtar, me kontribute të çmuara profesionale, njerëzore dhe qytetare, Gjeneralmajor Manushaqe Shehu përfaqëson me dinjitet vlerat më të larta të qytetit të Peshkopisë dhe të Dibrës në tërësi.

Propozohet:

T'i jepet titulli "QYTETARE NDERI E BASHKISË DIBËR" Gjeneralmajor MANUSHAQE SHEHUT, për kontribut të veçantë në shërbim të Aldheut, për promovimin e vlerave kombëtare e njerëzore të Dibrës, si dhe për shembullin frymëzues që përçon për brezat e rinj.

Propozuesi:

Dali Cani